

Geistlicher Baustein Nr.35

- Es ist Prüfungszeit -

Albanische Übersetzung

Guri i Ndërtimit Frymor Nr. 35

-Është koha e sprovës-

"Atëherë ju do të gëzoheni, ju që tani për pak kohë, nëse duhet, jeni të pikëlluar në shumë lloj sprovash, që qëndrueshmëria e besimit tuaj (që është shumë më i çmuar se ari i prishshëm, i cili megjithatë provohet në zjarr), të sjellë lavd, nder dhe lavdi në zbulesën e Jezus Krishtit." (1. Pjetri 1,1-9).

Ne dëshirojmë tani të flasim për disa fitimtarë. Ditët e Noeut u përshkruan nga Jezus Krishti se do të ishin si sot. Koha e Noeut është një hije e kohës së sotme. Jezusi iu referua dhe tha:

"Ashtu si ishte në ditët e Noeut, ashtu do të jetë edhe në ardhjen e Birit të njeriut." (Luka 17,26-27). Vëreni, në atë botë para përmbytjes, me ndoshta miliona njerëz, pati tetë fitimtarë. Tetë njerëz që fituan – ata ishin vërtet fitimtarë të vërtetë. Ishin tre bijtë e Noeut, gratë e tyre dhe Noeu me gruan e tij (Zanafilla 6-8). Tetë fituan dhe hynë në Arkë në kohën e duhur. Si e bënë? Ata dëgjuan Fjalën e Perëndisë. Ata nuk mbetën para derës. Ata u gjetën brenda derës. O miq të mi të dashur, mos e lini këtë derë të mbyllet!

Ka pasur gjithmonë një Arkë në shtëpinë e Perëndisë. Ishte një Arkë në ditët e Noeut për shpëtimin e njerëzve të tij. Ishte një Arkë në ditët e ligjit – Arka e Dëshmisë në ditët e ligjit. Ata ndiqnin Arkën e Besëlidhjes. Dhe tani ka një periudhë të tretë shpëtimi, si koha e Noeut, koha e Lotit dhe tani kjo kohë. Tani ka një Arkë, dhe kjo Arkë nuk është as një denominatë, as vepra të mira që bën ti, por është nëpërmjet një fryme (1. Kor. 12,13): Ne të gjithë jemi pagëzuar në një trup, në fushën e këtij mbretërimi, një pagëzim frymor. Nuk ka rëndësi sa i mirë, sa i keq apo çfarëdo tjetër, ti je në këtë mbretëri nëpërmjet pagëzimit të Frymës së Shejt (Ef. 4,4-6). Kjo është e vetmja rrugë që do të fitosh. Të gjithë ata që janë nën gjakun e derdhur, janë fitimtarë (Zbulesa 12,11), sepse ti vetë nuk mund të fitosh – është Ai që fitoi për ty (Rom. 8,37). Ti ke hyrë në pushim.

“Si e di unë atëherë që jam brenda?”

Shikoje çfarë lloj jete po jeton! Vetëm shiko rreth vetes! Shiko, a del thjesht automatikisht prej vetës? Apo duhet të mundohesh dhe ta tërheqësh me forcë, atëherë po e bën vetë. Por mos u përpiq ta bësh vetë.

Është si me një fëmijë të vogël, i cili po kërkon mëngën e xhupit, e shihni. “Vesh xhupin, i dashur.” Ai nuk mundet. Krah i vogël herë shkon sipër, herë poshtë, herë anash vrimës së mëngës. I duhet dora jote e fortë.

Oh, sa i gëzuar jam unë që mund t’ia dorëzoj thjesht dorën Atit dhe t’i them: “Zoti Jezus, unë nuk mund të hyj atje. Më ndihmo! Vishe ti xhupin mbi mua!” Unë ndalem së provuari. Lëre thjesht që ta bëjë Ai!

Nëse fëmija i vogël vazhdon të mundohet: “Oh, unë mundem vetë. Do t’ia dal.” Dhe krah i tij shkon gjithandej... Ai nuk ia del.

Po kështu as ti, as unë nuk mundemi, por nëse vetëm do të qëndrojmë të qetë (1 Sel. 4,11a) dhe ta lëmë Atë ta bëjë. Dorëzoju thjesht Atij: “Ja ku jam, Zot. Lëri që unë të mos jem asgjë. Unë dorëzohem. Vendose Ti dorën time në vendin e duhur.” Kjo është fitorja. Kjo është të kapërcesh.

Gjëja që duhet të kapërcesh je ti vetë, idetë e tua, çështjet e tua, dhe ta dorëzosh veten Atij. Ai e ka kapërcyer për ty. Ai e di rrugën, ne jo.

Në kohën e Noeut kishte tetë fitimtarë që hynë brenda. Ata u gjetën brenda. Tani shikoni, miq. Çfarëdo që të bëni, kushdo që po dëgjon tani ose do të dëgjojë më vonë, ora është shumë e vonë. Ju me siguri keni qëllime të mira, por bëhuni ata që gjenden brenda. Tani, mos u lodhni më kot! “Kështu nuk varet nga ai që do, as nga ai që vrapon, por nga Perëndia që mëshiron.” (Rom. 9,14-18). Lëre thjesht Perëndisë! Dorëzoju thjesht Atij dhe ec më tej me një besim të përsosur, të kënaqur, se “atë që Perëndia e ka premtuar, është gjithashtu i fuqishëm ta bëjë.” (Rom. 4,19-21). Jo të bashkohesh me këtë apo atë denominacion, të vraposh këtu e atje e të provosh këtë apo atë. Dorëzoju thjesht Perëndisë dhe ec me Të, në paqe, qetësi, pa ndërprerje. Ec thjesht me Të! (Gal. 5,25). Kjo është e vërtetë.

Tani, ne presim të provojmë. Kjo është një mësim i mirë. Kush vjen te Perëndia, duhet së pari të sprovohet. Me çfarë të sprovohet? Me Fjalën. Kjo është prova e Perëndisë. A e besoni? Kushdo që vjen te Perëndia, duhet të sprovohet (Heb. 12,4-10). Kjo tregon pastaj vetëm një fëmijë të vërtetë të Perëndisë, e shihni, kur ai sprovon.

Dhe kur vjen sprovimi, ai ndodh që të shihet nëse ti mund të mposhtësh apo jo. Dhe Jezusi tha: „Kush fiton mbi të...“, sprovimi (Zbulesa 3,21). Sprovimi është gjëja më e madhe që mund të të ndodhë ndonjëherë. Unë besoj se është shkruar në Shkrim, Pjetri tha: „Sprovat tona vlejné më shumë për ne se sa ari i çmuar“ (1 Pjet. 1,6-7). Është kohë sprovimi. Është një dëshmi e mirë për ne se Perëndia është me ne, kur ne sprovohemi, sepse të gjithë bijtë e Perëndisë sprovohen dhe testohen.

Shadraku, Meshaku dhe Abed-Nego; Danieli ishte profeti (Danieli 3,8-30), dhe kjo ishte madhështia e kishës asokohe, dua të them, e nuses. Kishte shumë kisha, rreth dy milionë prej tyre u dërguan atje në robëri. Por vetëm ky ishte numri i fitimtarëve. Dhe këta fitimtarë u lanë të kalonin në sprovim. Dhe çdo fitimtar duhet të arrijë te sprovimi. Kur atyre u tha: „Hiqni dorë nga ajo që thotë Fjala, përndryshe do të hidhni në furrën e zjarrit“, ata mohuan gjithçka tjetër, por jo Fjalën (1 Gjonit 5,4).

„Jo kush e fillon; por kush e përfundon.“ Shumë e nisin vrapimin, por vetëm një e përfundon atë (2 Tim. 2,4-5; 1 Kor. 9,24-27). Do të ketë shumë kisha që do të fillojnë, shumë grupe njerëzish. Por do të ketë një grup që do ta përfundojë. Këta janë fitimtarët.

Vëreni, në kohën e Gjon Pagëzorit u gjetën gjashtë që fituan mbi sprovat. Në të gjitha epokat ata patën fitimtarë. Në kohën e Gjonit ishin gjashtë: Jozefi dhe Maria, Zakaria dhe Elizabeta, Simeoni dhe Hana. Një burrë dhe një grua, një burrë dhe një grua, një burrë dhe një grua; shihni, një hije e Krishtit dhe e kishës. Krishti dhe kisha; Krishti dhe kisha; Krishti dhe kisha.

Të fitosh mbi të thotë: „ta njohësh djallin në të gjitha dredhitë e tij.“ Shumë njerëz thonë: „Nuk ka djall. Është vetëm një mendim.“ Mos e besoni këtë! Ka një djall të vërtetë. Ai është po aq i vërtetë sa ti, sa çdo njeri, një djall i vërtetë, dhe ti duhet ta njohësh si të vërtetë. Ti duhet ta dish, ai është djall. Dhe kur ta njohësh dhe ta dish se ai është djall dhe është kundër teje, atëherë duhet, për të fituar mbi të, njëkohësisht të pranosh se Perëndia që është në ty është më i madh dhe më i fuqishëm se ai dhe se Ai që është në ty e ka mposhtur tashmë. Dhe përmes hirit të Tij ti je mbi të. Amen. Kjo është fitore e vërtetë, kur ti e kupton këtë.

Nëse kthen kokën prapa dhe thua: „Unë kam bërë këtë mëkat dhe e kam shkelur atë“, atëherë je i mundur.

Por, “tani pra, nuk ka më asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus, të cilët nuk ecin sipas mishit, por sipas Frymës.” (Rom. 8,1). Atëherë ti e kupton se e ke mposhtur.

Dhe ti e di se ai është një djall. Nuk mund të thuash: “Unë kam një sëmundje, por nuk besoj se është sëmundje.” Jo, është sëmundje. Për shembull, ti ke kancer, dhe nuk beson se është kancer? Sigurisht që është kancer. Por kujto: më i madh është Ai që është në ty, sesa ai që është në botë (1 Gjon. 4,4). Ti duhet të pranosh se Fryma e Shenjtë, që është në ty, tashmë e ka mposhtur këtë gjë. Dhe Ai është në ty, dhe ti mund të fitosh përmes Tij. Kjo është krejtësisht e arsyeshme, është pikërisht rruga që Shkrimi tregon. Fitore!

Zot Jezus, Ti na ke thënë si duhet ta bëjmë. Ti jo vetëm që na e ke thënë, por edhe na e ke treguar se si duhet ta bëjmë. Ti na ke udhëhequr. Na ke treguar se si bëhet: duke e marrë Fjalën në ne dhe duke u siguruar që të qëndrojmë tek kjo Fjalë. “Është shkruar” (Mat. 4,1-11) në çdo tundim, dhe të jemi të përlur, të ecim me përlulsi (Jak. 4,6). Atëherë ne kemi fituar, përmes Teje, përmes fuqisë Sate, e cila tashmë e ka mundur armikun tonë. Dhe e vetmja gjë që duhet të bëjmë, është të ecim thjesht në besim me përlulsi dhe ta besojmë atë. Ne tregojmë shenjë tonë të vulës së Frymës së Shenjtë, dhe Satani duhet të largohet. [1]

Perëndia e provoi atin e besimit, Abrahamin, sepse Ai i kishte dhënë një premtim. Dhe kur Perëndia bënte një premtim, Ai dëshiron të sigurohet që ky personi i premtimit është i denjë për të, përpara se të përmbushë atë që ka thënë ose premtuar. Kështu Abrahami u premtua që nëpërmjet pasardhjes së tij e gjithë bota do të bekohej (zanafilla . 22,14-19), se do të kishte një bir, dhe prej atij biri do të vinte një farë që do të bekonte të gjithë tokën (Rom. 4,13-21). Dhe Abrahami, kur iu dha premtimi, ishte 75 vjeç, dhe Sara, gruaja e tij, ishte 65 vjeçe. Por Bibla na thotë se Abrahami nuk dyshoi në premtimin e Perëndisë për shkak të mosbesimit, por u forcua në besim, duke i dhënë lavdi Perëndisë. Dhe Perëndia e sprovoi atë herë pas here, por ai duhej të vinte tek kjo sprovë e fundit, përpara se bekimi të mund të ndodhte.

Dhe kështu është me gjithë faren (pasardhësit) e Abrahamit. Perëndia na jep këtë sprovë e fundit, pikërisht përpara se të japë premtimin. Kjo sprovë e fundit është për të parë se si do të reagosh ti ndaj tij.

Dhe kur Ai i dha Abrahamit këtë sprovë, Ai e gjeti Abrahamin po aq besnik sa ishte në fillim. Sa bekim do të ishte, sikur ne, të cilët marrim premtimin e Tij për shërim, të qëndronim po aq besnikë sa qëndruam kur e pranuan atë këtu. – nuk ka rëndësi se çfarë tha doktori, po aq besnik të qëndrojmë.

Dhe kur e bëri këtë dhe nuk e mbajti pas djalit të tij të vetëm, por ishte gati të fusë thikën në kraharorin e Isaakut për të shkatërruar dëshminë e tij... Ai e kishte dëshmuar në gjithë tokën e njohur se do të kishte këtë djalë. Dhe pastaj, kur djali erdhi, i kërkohet të kthehet mbrapsht dhe të shkatërronte shpresën e vetme që kishte, që dëshmia e tij të përmbushej. Dhe kur Perëndia pa se ai ishte besnik ndaj besimit që kishte në Perëndinë, Perëndia e shikoi nga qielli dhe tha: „Jam betuar për vete Time që do të të bekoj dhe do të të shumëfishoj, dhe (Fara) pasardhësit e tu do të pushtojnë portën e armikut të tij.” Sa premtim i madh! [2]